

Ti konsiderohesh fëmijë nëse je nën moshën 18 vjeç



FËMIJË SI VIKTIMA TË MUNDSHME TRAFIKIMI

TË DREJTAT E TUA NË HOLANDË

A semi-circular graphic with a dashed white border. Inside, four hands of different colors (light green, light yellow, orange, and light brown) are reaching out towards the center. The background of this section is a gradient from light green on the left to orange on the right.

DISA
KËSHILLA DHE
KONTAKTE TË
DOBISHME PËR TË
TË NDIHMUAR



Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian



TI KE TË DREJTË TË FLASËSH

MIRË TË DIHET

Kujdestari yt do të të ndihmojnë të kesh në dispozicion **mbështetje falas** (ushqim, strehim, larje, mjekë, shkollë...) dhe do të sigurojë që të drejtat e tua të respektohen

Profesionistët (punonjësit e policisë, avokatët, kujdestarët, gjykatësit, mjekët etj.) janë persona të cilëve mund t'u besosh.

Një **kujdestar** ose **punonjës social** do të ndihmojë për të marrë vendime me ty dhe për ty

Ti ke të drejtë për **përkthyes falas**

Ti ke të drejtë për **avokat falas**, për shembull nëse akuzohesh për diçka gjatë procedurave gjyqësore ose nëse kërkon azil

PA PATUR FRIKË



COMENSHA

Nëse mendon se të kanë shfrytëzuar.

Telefono

033 -

448 11 86

ose shko te

<http://www.fromhereon.eu>

<http://childline.org.uk/>



NIDOS

(autoritet kujdestarie për fëmijë të ndarë)

Telefon

0031-302391200

Posta elektronike:

directie@nidos.nl



Mbrojtje për Fëmijë

ECPAT

Holandë

Shërbim ndihmës ligjor
falas

Telefon

003171-5160980

Posta elektronike

info@defenceforchildren.nl

MOS
NGURRO TË
KËRKOSH TË
DREJTAT E TUA!





Ç'MUND TË BËJË POLICIA PËR TY?

Policia është këtu për të të dëgjuar dhe ndihmuar nëse je viktimë e dhunës ose je detyruar të bësh diçka që nuk do dhe që është e dëmshme për ty.

Punonjësit e policisë janë njerëz të besuar.

Policia **NUK** do të të shkaktojë asnjë dëm.

Ti **NUK** do të ndëshkohesh për diçka që ke qenë i detyruar të bësh, edhe nëse është e gabuar apo kundra ligjit. Por ndonjëherë policia mund të mos kuptojë fillimisht, prandaj fol me punonjësin tënd social ose avokatin për këshilla.

PËR TË RAPORTUAR NJË
KRIM, OSE NËSE KE FRIKË PËR
SIGURINË TËNDE APO TË DIKUJT
TJETËR, TELEFONOJI POLICISË:

NËSE TË DUHET NDIHMË

URGJENTISHT

112

PËR ÇËSHTJE JO-URGJENTE

0031-900-8844

Ç'ËSHTË TRAFIKIMI NJERËZOR?

Ti ose një nga shokët e tu mund të jeni viktimë e trafikimit pa e kuptuar.

A ke qenë në një situatë ku të është dashur të:

- **bësh seks apo kryesh uepra seksuale?**
- **punosh** (për shembull, në shtëpinë e dikujt duke kryer punë shtëpiake apo kujdesur për fëmijë, në fabrikë apo në restorant)?
- **lypësh, ujedhësh ose kryesh krime?**
- **rritësh, mbash ose shesësh drogë?**
- **heqësh organet e tua për t'i shitur?**
- shlyesh një **'borxh'** duke punuar apo dhënë ndonjë shërbim tjetër? A ke qenë ti/familja jote nën kërcënim?

Nëse i përgjigjesh "po" njëres prej këtyre pyetjeve, ti ose shoku yt mund të jeni viktima trafikimi.

Trafikimi njerëzor është krim serioz dhe abuzim i të drejtave të tua. Bisedo me një profesionist të cilit i beson nëse je i shqetësuar, që të ndihmojë me ndaljen e abuzimit dhe me mbrojtjen e të rinjve të tjerë.

E DREJTA PËR T'U SHOQËRUAR NGA NJË I RRI TUR I BESUAR, E DREJTA PËR TË PATUR AVOKAT FALAS

NË TË GJITHA RASTET, KËRKOJI POLICISË TË TË SHPJEGOJË TË DREJTAT QË KE

NDIHMË MJEKËSORE FALAS DHE PËRKTHYES FALAS



Ç'DO TË BËJË KUJDESTARI PËR TY?

- Në Holandë, të gjithë fëmijëve pa një përgjegjës ligjor u caktohet një kujdestar deri sa të mbushin 18 vjeç.

Kujdestari yt do të sigurojë që të gjitha vendimet rreth kujdesit dhe mbrojtjes tënde të merren në interesin tënd të plotë.

Kujdestari yt do të të ndihmojë të kesh në dispozicion kujdes mjekësor dhe psikologjik, shkollim dhe strehim të përshtatshëm.

Kujdestari yt do të mbështesë edhe procesin e aplikimit tënd për leje qëndrimi dhe do të të gjendet për t'iu përgjigjur pyetjeve që ke.

PËRKTHYESIT

- Ti ke të drejtën për një përkthyes profesionist, pa pagesë, gjatë seancave gjyqësore dhe intervistave nga policia. Do të pyetesh gjithmonë nëse parapëlqen përkthyes apo përkthyesë. Nëse nuk ndjehesh lirshëm me përkthyesin, mund t'i kërkosh kujdestarit tënd për një tjetër. Është me rëndësi të dish se përkthyesi yt duhet të respektojë konfidencialitetin e bisedave që shkëmbeni.

Mos harro
se kujdestari është
dikush tek i cili mund
të kesh besim. Ai/Ajo
do të veprojë me ty
dhe për ty.



AVOKATËT

- Në Holandë, si fëmijë ti ke të drejtën për **avokat falas**.
- Nëse je viktimë trafikimi, një avokat do të caktohet nga "Bordi i ndihmës ligjore" (Raad voor de Rechtsbijstand).
- Edhe Nidos, organi i kujdestarisë për fëmijë të ndarë, mund të të gjejë një avokat.

Sa konfidencial është informacioni që ndahet me avokatët?



- Informacioni që do të ndash me avokatin tënd është përgjithësisht konfidencial. Megjithatë, informacioni në një kërkesë për azil mund të ndahet, megjithëse jo me qeverinë nga vendi yt i prejardhjes. Në të njëjtën mënyrë, informacioni lidhur me një situatë trafikimi mund të ndahet me policinë, **por vetëm për të të mbrojtur ty**.






SHËNDETËSIA

- Nëse qëndron ligjërisht në Holandë, ke në dispozicion një mjek falas, me të cilin mund të diskutosh çështjet e tua shëndetësore.
- Nëse nuk po qëndron ligjërisht në Holandë, ke vetëm të drejtën e kujdesit mjekësor falas që është i nevojshëm.
- Kujdestari yt do të sigurohet që të marrësh kujdesin mjekësor që të nevojitet.

- Kujdestari ose avokati yt për imigrim mund të të informojnë rreth mundësive që ke. Ky mund të jetë një proces tepër i gjatë dhe i ndërlikuar.

- Nëse je nga një vend tjetër, mund të të duhet leje për të qëndruar këtu. Kjo mund të thotë se duhet të aplikosh për azil ose leje qëndrimi për të qëndruar në Holandë. Mund të aplikosh për azil në kufi ose në çdo pikë aty e tutje me ndihmën e kujdestarit ose avokatit tënd.






ARSIMI

Cilat janë kushtet e të drejtës për hyrje në shkollë?

- Në Holandë, të gjithë fëmijët (nën moshën 18) kanë hyrje falas në arsim. Kujdestari do të të ndihmojë të gjesh arsim të përshtatshëm.

- 
- Por ki parasysh se nuk të duhen dokumente zyrtare apo status imigracioni për të përfituar nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve.






INFO-KONTAKTE







Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajta e këtij botimi është përgjegjësi ekskluzive e ECPAT Francë dhe partnerëve të tij në projektin ReACT: ECPAT Belgjikë, ECPAT Gjermani, ECPAT Holandë dhe ECPAT MB dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

